

DEKRET
Nr. 442, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Francesco Altimari**

“Në vlerësim të meritave të dalluara, të fituara falë punës së pandërprerë si profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në forume universitare dhe akademike të nivelit ndërkombëtar në Itali dhe në vende të tjera, duke dhënë një kontribut thelbësor në zhvillimin e kërkimit shkencor në gjuhësi shqipe dhe ballkanike, si edhe në vlerësimin e thesarit gjuhësor dhe historik shqiptar, si një nga themelet e së ardhmes të dialogut ndërkulturor mbarëmesdhetar”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj